



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME TEKNIKE EKONOMIKE TIRANË

Nr. 1087 prot.

Data 26.11.2024

Lënda: Njoftim për vend të lëvizje paralele

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive"; të udhëzimit nr.759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publik të arsimit dhe formimit profesional".

Shkolla e mesme Teknike Ekonomike Tiranë ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin mesimdhënes i kultures profesionale me kohë të pjesshme :

- 5 (pesë) mesimdhënes të kultures profesionale i moduleve (teori dhe praktike profesionale nivelim e V KSHK ne arsimin pas te mesmes "Ndermjetesim i pasurive te paluajtshme" me kohe të pjesshme në drejtimin Ekonomi-Biznes.
- 4 (katër) mesimdhënes të kultures profesionale i moduleve (teori dhe praktike profesionale nivelim e V KSHK ne arsimin pas te mesmes "Dizajn Mode" me kohe të pjesshme që do të mbulojnë ngarkesën mësimore.

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizje paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit publik të AFP-së;
- b) të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

2. Dokumentet e aplikimit:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në),
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të Shkollës Teknike Ekonomike

Tiranë brenda datës 12.12.2024

